

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"6 MARSI" Shpk

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shogëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;
- “Shoqëri” është Shoqëria “6 MARSI” SHPK

Kreu I - Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1: Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më datë 13/12/2022 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin “6 MARSI” SH.P.K. nga ortaku si më poshtë:

Enkelev Kurti, i biri i Luanit, i datëlindjes 26.09.1966, me nr. personal G60926092G.

Neni 2: Objekti

2.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: çdo lloj aktiviteti në fushën e ndertimeve civile industriale-turistike-bujqesore nen e mbi pese kat. Ndertime banese banimi e sherbimesh mbi 8-kat. Ndertime rruge te kategorise IV dhe V. Ndertime ujesjelles, kanalizime, kanale e impiante vadites. Ndertim vepra hidroenergjetike. Punime karpentjerie prej druri dhe konstruksione metalike. Instalim i impianteve higjenosanitare, kuzhina, lavanteri dhe mirembajtje e tyre. Gjithashtu shoqeria do të kryej aktivitet në menaxhimin dhe konstruktimin ne fushen e turizmit, hotelerise, bar, restorant, salla konferencash, Spa Center etj. Importi, eksporti dhe tregtimi me shumice e pakice të artikujve të ndryshme.

2.2 Objekti mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 3: Kohëzgjatja

Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

Neni 4: Selia - Stema

4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Strukture turistike Kati i pare, zona kadastrale 2291, parcela 40, Kryemedhenje, Njesia Administrative Golem, Kavaje"

4.2 Selia mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

4.3 Shoqëria ka stemën e saj e cila përbëhet nga të dhënat e saj (sipas rastit adresa e selisë, NUIS-i apo informacione të tjera) dhe emrin i saj. Stema përfundimtare e shoqërisë do të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve pas regjistrimit të shoqërisë.

Kreu II - Kapitali

Neni 5: Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë dhe shlyhet dhe zotërohet si më poshtë:

Ortaku themelues Enkelev Kurti është zotërues i një kuote të barabartë me 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, kapitali i shoqërisë mund të zvogëlohet ose të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga Asambleja e Ortakëve të një eksperti për vlerësimin e këtyre kontributeve sipas kërkesës së administratorit.

Neni 7: Transferimi i kuotave të kapitalit

7.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) shitblerjes;
- b) trashëgimisë;
- c) dhurimit;
- ç) Dhënies si kontribut në kapitalin e një shogërie tjetër;
- d) cdo mënyre tjetër të parashikuar me lig).

7.2 Ortaku që dëshiron të shesë kuotat e tij detyrohet më parë t'ia ofrojë këto kuota ortakëve të shoqërisë në të njëjtat kushte.

KREU III - ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8: Organet Vendimmarrëse

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- 1- Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
- 2- Administratori.

Neni 9: Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë

- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfagësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) ndryshimin e selisë së shoqërisë;
- j) marrjen e një huaje në çfarëdo vlere nga ortakët;
- k) marrjen e një kredie apo huaje nga një institucion financiar;
- l) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 10: Administrimi

10.1 Administrator i parë i shoqërisë është ortaku Z. Enkelev Kurti. Mandati i tij fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe përfundon në datën 13/12/2027.

10.2 Administratorët e mëpasshëm emërohen për një afat 5 vjeçar. Megjithatë, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që mandati i Administratorit të jetë më i shkurtër. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

10.3 Administratori shkarkohet dhe/ose emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me një shumicë prej 51% të votave.

Neni 11: Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfagësojë shogërinë tregtare në raport me të tretët dhe pranë organeve shtetërore;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara ortakut në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posagme me rëndësi të vegantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Neni 12: Përgjegjësitë e Administratorit

12.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

12.2 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shogëritë Tregtare“, administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të vegantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e gëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

12.3 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

12.4 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

12.5 Në mënyrë të vecantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shogëritë Tregtare" kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakut kontributet;
- b) u paguan ortakut interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

12.6 Përvec padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakut ka të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Kreu IV - Viti financiar - ekspertët

Neni 13: Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti 1 parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 13: Ekspertët

13.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë që i ngarkuar nga ana e ortakeve.

13.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar.

Kreu V - Prishja —riorganizimi i shoqërisë

Neni 14: Prishja dhe likuidimi

14.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohe:

- a) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

14.2 Në këtë rast Ortaku merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej ti emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

14.3 Prishja e shogërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

14.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku.

Neni 15: Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shogëritë tregtare.”

Neni 16: Baza Ligjore

16.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisllacionit shqiptar.

16.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 17: Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAKU I SHOQERISE “6 MARS” SHPK

ENKELEV KURTI

(emër, mbjemër, firmë)